


KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES -
FUSHË KOSOVË



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR PËR VITIN QË
PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2025

Prishtinë, Prill 2026

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3 - 5
RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE.....	6
PASQYRAT FINANCIARE PËR PËRIUDHEN KONTABEL 31 DHEJETOR 2024.....	1 - 22

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin e KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES - PRISHTINË

Opinion i pakualifikuar:

Ne i kemi audituar Pasqyrat Financiare përcjellëse **KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES** tutje Referuar ("KMDK") me adresë: Rr. Gazmend Zajmi nr. 41, 10000 Prishtinë, Rpublika e Kosovës, që nga Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2025, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar, Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet, si dhe Përmbledhjen e Politikave Kryesore të Kontabilitetit dhe Shënimeve Shpjeguese.

- Për mendimin tonë, Pasqyrat Financiare të "KMDK", paraqesin gjendjen e drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën financiare dhe rrjedhat e saj të parasë për vitin e përfunduar, në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF).

Ne e kemi kryer auditimin tonë në perputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë. Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga shoqëria dhe në perputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit - Theksim i Çështjes

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne terheqim vemendjen lidhur me momentet e mëposhtme:



ProAudit

Tel: +383 44 126 395

Email: proaudit34@gmail.com

- Siç është prezantuar në shënimin 7 - Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera, shumat e raportuar më 31 dhjetor 2025 ishin 2,945,459 Euro, krahasuar me 1,797,285 Euro më 31 dhjetor 2024. Kjo paraqet një rritje të konsiderueshme prej mbi 63% brenda një periudhe njëvjeçare. Rritja e tillë në nivel të lartë e llogarive të arkëtueshme ngre shqetësime për mundësinë e krijimit të borxheve të dyshimta. Rritja e shpejtë e arkëtueshmeve pa një provizion të mjaftueshëm për humbje të mundshme tregon se provizioni i llogarive të arkëtueshme nuk është në harmoni të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS) dhe me aktet e brendshme të shoqërisë.

Metodat alternative të auditimit të përdorura nuk kanë mundur të përmbushemi mbi saktësinë dhe plotësinë e raportimit të këtyre llogarive në pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2025. Gjithashtu, nuk janë marrë garanci të mjaftueshme për vlefshmërinë dhe arkëtueshmërinë e plotë të tyre.

- Siç është prezantuar në Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet, KMDK ka raportuar "Korrigjimet e periudhave paraprake" në shumën prej (1,038) Euro për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 (viti krahasues 2024: (43,532) Euro). Megjithatë, përdorimi i metodave alternative të auditimit nuk ka mundur të sigurohemi për saktësinë dhe plotësinë e raportimit të këtyre shumave.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant; për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare; të jenë të liruara nga gabimet materiale, nga mashtrimi apo nga gabimi; zgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit; bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim mbi këto Pasqyra Financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë e zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë Pasqyrat Financiare të liruara nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave që të arrijmë dëshmi audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në Pasqyrat Financiare.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të Pasqyrave Financiare, qoftë nga gabimi apo nga mashtrimi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare të entitetit, në mënyrë që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Gjithashtu, auditimi përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura dhe



ProAudit

Tel: +383 44 126 395

Email: proaudit34@gmail.com

arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të Pasqyrave Financiare. Ne besojmë që dëshmitë për auditim që i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura që të ofrojmë bazë për mendimin tonë të auditorit.

Hajdar Hoxhaj

Auditor Ligjor Nr. 88



ProAudit



SH.P.K.

Adresa: Rr. Behar Begolli,
Linda Premium, 10 000 Prishtinë

Prishtinë, më
28 prill 2026



ProAudit

Tel: +383 44 126 395

Email: proaudit34@gmail.com

RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të **KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES** tutje Referuar ("KMDK") si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10. Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është pergatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 per pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

Ne jemi angazhuar si auditor te kompanisë "KMDK" për periudhën 01 janar 2025 - 31 dhjetor 2025, përmes Prokurimit Publik. Si pjesë e auditimit ne kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

Vlerësimet kontabël

Kompania përdor vlerësimet kontabël në fusha të rëndësishme të pasqyrave financiare përfshirë jetëgjatësinë e aktiveve, dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe njohjen e provizioneve nga çështjet e mundshme gjyqësore. Përcaktimi i politikave lidhur me vlerësimet kontabël bëhet bazuar në përvojën historike dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe të industrisë.

Përgjigja e auditorit

- Vlerësimi i përshtatshmërisë së vlerësimeve kontabël,
- Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve të bëra nga menaxhmenti,
- Rishikimi i saldove dhe rillogaritja e shumave të përdorura në supozime dhe metoda për të arritur në vlerësimet kontabël.

Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në menyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese. Ne konfirmojmë që opinionin e auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit. Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Hajdar Hoxhaj

Auditor Ligjor Nr. 88

Prishtinë, më

28 prill 2026

KMDK.SH.A
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C
KOMPANJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO O.O
Nr. 05-660/01
Dt. 24 04, 2026 Shitje 23
Prishtinë



KMDK
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN
E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE
Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025
NUI: 811380617

PRISHTINË

PËRMBAJTJA:

1.	<u>DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË</u>	2
2.	<u>PASOYRA E POZITËS FINANCIARE MË 31.12.2025</u>	3
3.	<u>PASOYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31.12.2025</u>	4
4.	<u>PASOYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31.12.2025</u>	5
5.	<u>PASOYRA E RRHJEDHËS SË PARASË PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31.12.2025</u>	6
6.	<u>PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL – SHPALOSJA PËR VITIN 2025</u>	7-22

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

NUI: 811380617

Deklaratë e Pajtueshmërisë

Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2025

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues kontabël 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, rrjedhës së parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim* dhe UA-të në fuqi.

Kryeshefi Ekzekutiv:

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula



Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit:

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Handwritten signature of the Chief Financial Officer and Treasurer.

Prishtinë,

03.03.2026

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025
(Të gjitha shumat në EURO)

	Shënimi	31.12.2025 €	31.12.2024 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	5	2,519,561	1,767,743
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	2,945,459	1,797,285
Stoqet	6	27,094	111,419
Pasuritë e tjera afatshkurtra	8	28,690	9,153
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		5,520,805	3,685,600
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	9	34,831,647	1,624,108
Gjithsej pasuritë afatgjata		34,831,647	1,624,108
Gjithsej pasuritë		40,352,452	5,309,708
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare	10	195,249	220,489
Te hyrat e shtyra nga grantet, pjesa afatshkurter	11	34,760	34,757
Te pagueshmet tjera - Tatimet	12	94,112	73,618
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		324,122	328,864
Detyrimet afatgjata			
Grantet dhe donacionet , pjesa afatgjatë	11	105,068	339,829
Gjithsej detyrimet afatgjata		105,068	339,829
Gjithsej detyrimet		429,190	668,693
EKUITETI			
Kapitali aksionar		25,000	25,000
Fitimet e mbajtura		4,935,228	3,323,880
Rezerva e Rivlerësimit		34,963,034	1,292,135
Gjithsej ekuiteti		39,923,262	4,641,015
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		40,352,452	5,309,708

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti më 03.03.2026

Kryeshefi Ekzekutiv:  Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit:

Kontabilisti i Certifikuar:

 #4929

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2025	2024
		€	€
	<i>Shënimet</i>		
Të hyrat	13	4,152,840	3,385,907
Kostoja e shitjes	14	1,302,476	1,082,106
Fitimi / (humbja) bruto		2,850,364	2,303,801
Të ardhurat tjera	13	633,207	42,818
Shpenzimet pagave	15	447,124	327,205
Shpenzimet administrative	16	735,310	120,184
Shpenzimet e Zhvlersimit	9	510,750	599,164
Shpenzimet tjera			3,500
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,790,386	1,296,566
Të hyrat nga interesi			
Shpenzimet e interesit			
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,790,386	1,296,566
Shpenzimet e tatimit në fitim	17	179,039	131,357
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,611,348	1,165,209

* Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare individuale.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
 Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025
 (Të gjitha shumat në EURO)

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 01.01.2024	25,000	2,158,671	1,340,067	3,523,738
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,165,209		1,165,209
Rezerva e rivlerësimit		-	(4,400)	(4,400)
Korrigjimet e periudhave paraprake			(43,532)	(43,532)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000	3,323,880	1,292,135	4,641,015
Gjendja më 01.01.2025	25,000	3,323,880	1,292,135	4,641,015
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,611,348		1,611,348
Rezerva e rivlerësimit		-	(3,400)	(3,400)
Korrigjimet e periudhave paraprake			(1,038)	(1,037)
Shtesa e Rezervës së Rivlerësimit			33,675,337	33,675,337
Gjendja më 31 dhjetor 2025	25,000	4,935,228	34,963,034	39,923,263

** Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare individuale.*

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË
 Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025
 (Të gjitha shumat në EURO)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor:	2025	2024
	€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi /(humbja)i / e vitit	1,611,348	1,165,209
	1,611,348	1,165,209
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(1,147,076)	(314,889)
(Rritja) / zvogëlimi në stocë	84,325	(73,426)
(Rritja) / zvogëlimi në parapagime dhe kërkesat tjera	(8,340)	129,769
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(24,336)	41,119
Rritja / (zvogëlimi) në pasuritë e tjera	2,927	-
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet tjera	(47,469)	(30,903)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet tatimore	-	-
Rritja / (zvogëlimi) në të hyrat e shtyra tatimore	-	165,242
Zhvierësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	510,750	599,164
Paraja e gjeneruar nga Operacionet	(629,219)	516,076
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	982,129	1,681,285
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(191,137)	(402,423)
Investimet ne Vijim - Projekti KFW		
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(38,193)	(402,423)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Rezervat e rivlerësimit	(3,400)	(4,400)
Korigjimet e periudhave paraprake	(1,035)	(43,532)
Ripagimi i granteve dhe donacione	(34,758)	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	(39,194)	(47,932)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	751,798	1,230,930
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	1,767,763	536,813
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	2,519,561	1,767,743

* Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare individuale.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

1. Informacion i përgjithshëm

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosove SH.A. (që më poshtë do t'i referohemi si "Kompania") është themeluar si Shoqëri Aksionare, ne 21/12/2005, dhe është e regjistruar në Agjencionin për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës.

Selia e regjistruar e Kompanisë dhe vendi kryesor i aktivitetit është në Prishtinë, Rr.Gazmed Zajmi nr. 41.

Aktiviteti kryesor i biznesit është menaxhimi i deponive sanitare në Kosovë.

Kompania është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës me 100% të Aksioneve në vlerë 25,000 Euro.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarate e përputhshmërisë së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM (SNRF për NVM) të cilat janë kornizë raportuese e kërkuar me Ligj në Kosovë.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Euro, e cila është monedha funksionale për Kompaninë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në vecçanti, informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në paragrafin e mëposhtëm ashtu si edhe në shënimet shpjeguese të mëposhtme.

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

3. Përmbledhje e politikave kontabël

a. Ndryshime në politikat kontabël

Nuk ka ndryshime në politikat kontabël në vitet e paraqitura.

b. Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë paraqet diferencën ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

c. Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative të Kompanisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, si dhe llogaritë e pagueshme. Gjatë periudhave të raportimit, Kompania nuk ka pasur investime në letra me vlerë të kapitalit apo në instrumente borxhi në kuadër të vazhdimësisë së aktivitetit.

Instrumentet financiare jo-derivative maten fillimisht me vlerën e drejtë. Për instrumentet që nuk maten me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kësaj vlerë i shtohen edhe kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja e mëtejshme e instrumenteve financiare jo-derivative përshkruhet si më poshtë.

Një instrument financiar njihet në momentin kur Kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen kur të drejtat kontraktuale të Kompanisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar përfundojnë, ose kur Kompania transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin apo thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet që burojnë nga ai aktiv. Blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregimit, pra në datën kur Kompania angazhohet për të blerë ose shitur aktivin.

Detyrimet financiare nuk njihen kur detyrimet kontraktuale të Kompanisë përfundojnë, shlyhen ose anulohen.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

(ç) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë vlerat në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka, si dhe depozitat bankare afatshkurtra.

Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë gjithashtu depozitat e mbajtura si garanci nga bankat, me maturitet deri në tre muaj nga data e origjinale.

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar, të zvogëluar për humbjet nga zhvlerësimi.

Furnitorë dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim maten me koston e amortizuar.

Hua dhe kredi

Pas njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me koston e amortizuar, ku çdo diferencë ndërmjet koston fillestare dhe vlerës së riblerjes njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumentet e tjera financiare jo-derivative maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet financiare është diskutuar në Notën 3(k).

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

(d) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto, minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka).

Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të atribuueshme për blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vendosjen e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme për përdorim, si dhe koston e montimit, heqjes së elementeve dhe kthimit të mjedisit ku kanë qenë të vendosur në gjendjen e mëparshme.

Shpenzimet kapitale për aktivet gjatë ndërtimit regjistrohen në llogarinë "Punë në proces" dhe kapitalizohen duke u transferuar në kategorinë përkatëse të aktivit kur ai përfundon; në këtë moment fillon edhe aplikimi i amortizimit sipas normës përkatëse të kategorisë.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

Rritja e vlerës së aseteve, që rrjedh nga rivlerësimi, është njohur si "Rezervë e rivlerësimit" në kapitalin vetanak, në përputhje me kërkesat e SNK 16

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

3. Pëmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e mirëmbajtjes dhe shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

d. Aktivët afatgjata materiale

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet me metodën lineare, me norma që pasqyrojnë jetën mesatare ekonomike të dobishme të aktivit. Toka dhe aktivët në ndërtim nuk amortizohen.

Jetët e dobishme të pritshme për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

	<u>2025</u>	<u>2024</u>
• Mjete transportuese	20%	20%
• Pajime dhe makineri	10%	10%

(e) Aktivët e marra me qira

Aktivët e marra me qira konsiderohen si qira operative dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

(ë) Inventaret

Inventaret mbahen me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe shitjen e tij. Kostot përfshijnë shpenzimet që ndodhin gjatë blerjes së inventareve dhe shpenzimet për t'i sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese.

(f) Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka prova objektive që tregojnë se një ose më shumë ngjarje të ndodhura kanë pasur një ndikim negativ në flukset e pritshme të mjeteve monetare të aktivës financiare.

Humbja nga zhvlerësimi e një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, të diskontuara me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivët financiare që janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet në grupe që bartin karakteristikën e ngjashme rreziku.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja e zhvlerësimit ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit. Për aktivët financiare që maten me kosto të amortizuar, anulimi njihet në fitime ose humbje.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(ii) Aktivët jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla, vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivës.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi apo e një njësie gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje.

(g) Përfitimet e punonjësve

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve për të kontribuar në pensionet e detyrueshme, në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Lejet vjetore të paguara

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara për lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësve gjatë periudhës.

(gj) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe ekziston mundësia që të kërkohet një dalje e burimeve, e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe kur mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i detyrimit.

Nëse efekti është material, provizionet përcaktohen duke diskontuar flukset e ardhshme të parasë para taksave me një normë që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, edhe rrezikun specifik të detyrimit.

Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe, nëse nuk ekziston më mundësia që burimet ekonomike të kërkojnë për të shlyer detyrimin, provizionet kthehen pas. Provizionet përdoren vetëm për arsyen për të cilën janë njohur fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje operative të ardhshme, dhe as aktiva apo detyrime të rastit nuk njihen.

(h) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në fitim ose humbje kur rreziqet dhe përfitimet thelbësore i janë transferuar blerësit.

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në fitim ose humbje në përpjesëtim me fazën e përbushjes së transaksionit në datën e raportimit. Faza e përbushjes vlerësohet duke iu referuar vrojtimit të punës së kryer.

Asnjë të ardhur nuk njihet nëse ekziston pasiguri e madhe lidhur me rikuperimin e pagesës së detyrueshme, kostot shoqërore, kthimet e mundshme të mallrave ose përfshirjen e vazhdueshme të drejtimit me mallrat.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Shpenzimet

Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qira operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë nga qiradhënësi njihen si pjesë integrale e pagesës totale të qirasë gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi mbi fondet e investuara në depozita bankare (nëse ka), si dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, amortizimin e zbritjeve mbi provizionet, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të matura nëpërmjet fitimit ose humbjes, si dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura mbi aktivet financiare.

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(j) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, si dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës së tyre tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të aplikohen kur diferencat e përkohshme të anulohen, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi fiskal përkatës.

(k) Standarde dhe politika / interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Një grup standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime të standardeve nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të Shoqërisë. Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(l) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe notat shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat përkatëse të vlerësimit. Kur është e aplikueshme, informacioni i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqitet në notat shpjeguese specifike të aktiveve dhe detyrimeve.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Kërkesa për arkëtim

Vlera e drejtë e kërkesave për arkëtim, klientëve dhe llogarive të tjera të arkëtueshme matet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, të diskontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

(m) Informacion krahasues

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të qëndrueshme me aplikimin e politikave kontabël të Shoqërisë. Aty ku është e nevojshme, shuma të caktuara në pasqyrat financiare të vitit paraardhës riklasifikohen për t'u përputhur me prezantimin e vitit aktual.

4. Drejtimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që rrjedhin nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimin e Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset për identifikimin, matjen dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe qasjen ndaj menaxhimit të kapitalit. Informacione të mëtejshme sasiore janë paraqitur në shënimet përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi i Shoqërisë mban përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e kornizës së menaxhimit të rrezikut.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet Shoqëria, për të vendosur limite dhe kontrole të përshtatshme, si dhe për të monitoruar respektimin e këtyre limiteve. Politikat dhe sistemet përkatëse rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë.

Shoqëria, përmes trajnimeve dhe zbatimit të standardeve dhe procedurave të brendshme, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të strukturuar dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre në kuadër të menaxhimit të rrezikut.

Grupi në zyrat qendrore monitoron mënyrën se si menaxhmenti siguron përputhjen me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë dhe të Grupit, si dhe vlerëson përshtatshmërinë e strukturës së menaxhimit të rrezikut në raport me profilin e rrezikut të Shoqërisë.

Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe në banka, overdraftet bankare, kërkesat për arkëtim, llogaritë e pagueshme, detyrimet e shtyra dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

4. Drejtimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali, me qëllim ruajtjen e besueshmërisë së investitorëve dhe kreditorëve, si dhe mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të aktivitetit.

Zyra Qendrore monitoron kthimin nga kapitali, të cilin Shoqëria e përcakton si raporti ndërmjet të ardhurave neto nga operimi dhe totalit të kapitalit aksionar. Drejtimi dhe Zyra Qendrore monitorojnë gjithashtu nivelin e dividendëve të shpërndarë aksionarëve të zakonshëm.

Shoqëria synon të ruajë një balancë ndërmjet kthimeve më të larta që mund të arrihen përmes niveleve më të larta të borxhit dhe përfitimeve nga siguria që ofron një pozicion i fortë kapitali.

Nuk ka pasur ndryshime në mënyrën e menaxhimit të kapitalit gjatë vitit raportues. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave për kapital minimal të vendosura nga autoritete të jashtme rregullatore.

Ndikimi mbi likuiditetin

Vëllimi i financimit në treg është reduktuar kohët e fundit. Këto rrethana mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të siguruar financime të reja, nëse nevojiten, si dhe për të rrefinancuar detyrimet ekzistuese me kushte të ngjashme me ato të aplikuar në transaksione të mëparshme.

Ndikimi mbi klientët / huamarrësit

Klientët e Shoqërisë mund të ndikohen nga niveli i ulët i likuiditetit në treg, gjë që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale. Përkeqësimi i kushteve operuese të klientëve mund të ndikojë gjithashtu në flukset e parashikuara të parasë dhe në vlerësimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare.

Bazuar në informacionin e disponueshëm, Drejtimi i Shoqërisë ka reflektuar vlerësime të rishikuara të flukseve të pritshme në llogaritjen e humbjeve nga zhvlerësimi, aty ku është konsideruar e nevojshme.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

5. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 Dhjetor 2025 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Paraja në bankë	2,518,579	1,767,580
Paraja në arkë	983	163
TOTAL:	2,519,561	1,767,743

6. Stoqet

Stoqet me 31 dhjetor 2025 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Stoqet	27,094	111,419
TOTAL	27,094	111,419

7. Llogarite e arketueshme tregtare dhe të tjera

Llogarite e arketueshme tregtare dhe të tjera me 31 dhjetor 2025 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Llogarite e arketueshme tregtare dhe tjera	2,989,430	1,818,919
Provizionimi I akumuluar	(21,635)	(21,635)
Provizionimi I vitit aktual	(22,336)	
TOTAL	2,945,459	1,797,284

8. Parapagimet dhe kërkesat tjera

Parapagimet dhe kërkesat tjera me 31 dhjetor 2025 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Parapagim I sigurimit	3,185	1,498
Parapagimi I qirase	3,640	
Parapagimet e furnitoreve	3,069	7,655
Provizion per konteste gjyqesore	(110)	
Teprice nga pagesa TVSH-Kreditim	18,907	
TOTAL:	28,690	9,153

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

9. Prona, pajisjet dhe implantet

Përkrahimi	Tokat	Infrastruktura e deponisë së mbeturinave	Automjete transportuese, Kontinierët, Peshoret industriale dhe Inventare per zyre	Totali
Kostot:				
Me 31 dhjetor 2023		10,030,337	7,115,202	17,145,539
Shtesë			402,419	402,419
Me 31 dhjetor 2024		10,030,337	7,517,621	17,547,958
Shtesë	31,322,000	1,939,645	242,956	242,956
Rezerva e rivlerësimit (shëna 2025)			413,692	33,675,337
Hegjet			(200,000)	(200,000)
Transferi		1,531,898	(1,531,898)	
Me 31 dhjetor 2025	31,322,000	13,501,880	6,442,371	51,266,251
Zhvlersimi i akumuluar:				
Me 31 dhjetor 2023		(9,816,839)	(5,507,850)	(15,324,689)
Zhvlersimi i vitit		(35,056)	(564,108)	(599,164)
Me 31 dhjetor 2024		(9,851,895)	(6,071,958)	(15,923,853)
Zhvlersimi i vitit		(341,436)	(169,315)	(510,751)
Transferi		(575,549)	575,549	
Me 31 dhjetor 2025		(10,768,880)	(5,665,724)	(16,434,604)
Vlera neto kontabël 31 dhjetor 2024:		178,442	1,445,663	1,624,105
Vlera neto kontabël 31 dhjetor 2025:	31,322,000	2,733,000	776,647	34,831,647

Rivlerësimi i aseteve është kryer në përputhje me kërkesat e SNK 16 "Pasuritë, Implantet dhe pajisjet". Subjekti aplikon modelin e rivlerësimit për klasën Toka, Infrastruktura e deponisë, Automjetet - Makinat e lehta, Kamionët dhe Makineritë e Rënda, Kontejnerët Administrativë, Peshoret Industriale, ku aktivitetet matet me vlerën e tij të rivlerësuar (vlera e drejtë në datën e rivlerësimit), minus zhvlerësimin e akumuluar pas rivlerësimit. Rritja e vlerësimit rezultat i rivlerësimit është njohur në kapitalin vetanak si "Rezervë e rivlerësimit". Zhvlerësimi pas rivlerësimit bazohet në jetën e mbetur të dobisime të aseteve.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

10. Llogarite e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogarite e pagueshme tregtare dhe të tjera me 31 dhjetor 2025 paraqiten si me poshtë:

	<u>Me 31 dhjetor 2025</u>	<u>Me 31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Llogarite e pagueshme tregtare dhe tjera	195,249	220,489
Total:	195,249	220,489

11. Të hyrat e shtyra nga grantet

Të hyrat e shtyra nga grantet me 31 dhjetor 2025 paraqiten si me poshtë:

	<u>Me 31 dhjetor 2025</u>	<u>Me 31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Detyrimet e shtyra tatimore afatëshkurtera	34,760	34,757
Detyrimet e shtyra tatimore afatëgjata	105,068	339,829
Total:	139,828	374,586

12. Të pagueshmet tjera – Tatimet

Të pagueshmet me 31 dhjetor 2025 paraqiten si me poshtë:

	<u>Me 31 dhjetor 2025</u>	<u>Me 31 dhjetor 2024</u>
	€	€
Tatimi I mbajtur në burim për paga	6,676	5,888
Kontributet pensionale	9,289	8,806
Tatimi në qira	436	
Tatimi në fitim në koroprate-TM4 dhe CD 2025	70,669	
Tatimet tjera	7,042	58,924
Total:	94,112	73,618

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

13. Te hyrat nga shitja

Te hyrat nga shitja per vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2025 paraqiten si me poshte:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
	€	€
Te hyrat:		
Te hyrat nga shërbimet Publike	3,287,550	2,669,787
Te hyrat nga shërbimet Private	864,555	716,120
Nota debitore	735	
Te ardhurat tjera:		
Te hyrat nga grantet KFW JV-ICP MBH	419,432	
Te hyrat nga grantet KFW GOPA INFRA	180,000	
Te hyrat e shtyera Grante dhe Donacione dhe te tjera	33,775	34,758
TOTAL:	4,786,047	3,428,727

14. Kostoja e shitjes

Kostoja e shitjes per vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2025 paraqitet si me poshte:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
	€	€
Shp.Pagave Direkte	665,635	595,806
Pako dalese e punetorve	51,506	
Shpenzimet e derivateve	242,839	201,752
Shpenzimet e mirembajtjes	269,122	223,589
Kostot e Sigurimit	42,986	35,713
Shpenzimet tjera	30,388	25,246
Total:	1,302,476	1,082,106

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

15. Shpenzimet e personelit

Kostot e personelit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 paraqitet si me poshte:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
	€	€
Paga bruto	282,634	311,624
Pako dalese e punëtorve	77,072	
Shpenzimet tjera të paqave	87,418	155,812
Total:	447,124	467,436

16. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 përfshijnë:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
	€	€
Shpenzimet e energjisë elektrike	3,540	8,476
Shpenzimet e qirase	45,849	31,049
Shpenzimet për mirëmbajtje të automjeteve	1,771	1,546
Shpenzimet për furnizime të zyrës	11,045	17,070
Konsulencë nga KFW	599,432	
Provizionimi i LLA 2025	22,336	
Te tjera	51,337	62,044
Total:	735,310	120,185

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

17. Tatimi ne fitim

Tatimi mbi te ardhurat perbehet nga tatimi mbi te ardhurat e korporatave per vitin qe perfundon me 31 dhjetor 2025 dhe periudhes paraprake. Deklaratat tatimore paraqiten c;do vit, por fitimet ose humbjet e deklaruar per qellime tatimore mbeten provizore deri ne kohen kur autoritetet tatimore ekzaminojne kthimet dhe regjistrat e tatimpaguesit dhe leshohet nje vleresim perfundimtar. Ligjet dhe rregulloret tatimore te Kosoves jane subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

Shpenzimet e tatimit ne fitim per vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2025 paraqiten si me poshte:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
	€	€
Fitimi/humbja kontabel	1,790,387	1,296,566
Korrigjimi per shpenzimet		7,166
Korrigjimi per te hyrat tjera		9,840
Fitimi/Humbja para tatimit	1,790,387	1,313,572
Tatimi	179,039	131,357

18. Kontestet gjyqësore

Kompania është e përfshirë në disa procese gjyqësore që rrjedhin nga aktiviteti i saj operativ. Bazuar në vlerësimin e bërë nga zyra ligjore e kompanisë, probabiliteti i humbjes për shumicën e rasteve është vlerësuar si mesatar, prandaj nuk është njohur provizion në pasqyrat financiare për këto raste.

Vlera totale e pretendimeve në këto procese gjyqësore arrin në 317,824 €, dhe ato janë klasifikuar si detyrime kontingjente sipas kërkesave të IAS 37.

Për një rast ku probabiliteti i humbjes është vlerësuar si i lartë, kompania ka njohur provizion në shumën prej 110 € në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025.

Kompania do të vazhdojë të monitorojë zhvillimin e këtyre proceseve dhe do të bëjë rregullimet e nevojshme në pasqyrat financiare nëse rrethanat ndryshojnë.

19. Transaksionet me palet e lidhura

Nuk ka transaksione me palet e lidhura.

20. Ngjarjet pas dates se bilancit

Nuk ka ngjarje tjera pas dates se bilancin qe kerkojne rregullime ne pasqyrat financiare te periudhes kontabel 2025.

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVE SH.A.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha shumat në EURO)

21. Ngjarjet e jashtezakonshme

Nuk ka asnjë ngjarje pas dates se autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

22. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar me **03.03.2026**